

MERITA SAUKU BRUCI

**LETËRKËMBIMI I F. A. SANTORIT ME JERONIM DE RADËN
NË ARKIVIN QENDROR TË SHËTETIT-TIRANË**

*“La parte piu’ viva nella letteratura,
la sincera e’, in ogni modo,
passata ne’ carteggi”¹*

A. De Gubernatis

Në Arkivin Qendror të Shëtitit ndodhen 21 letra që ruhen në fondin e De Radës (Fondi 24, Dosja 54/9, fl. 11-44), ose më mirë të themi ajo që ka mbetur nga letrat që Santori i kish dërguar mikut të tij. Leximi i këtij letërkëmbimi të çmuar na njeh me të dhëna të panjohura më parë që kanë një rëndësi të veçantë për të hedhur dritë mbi jetën e Santorit, e cila deri më sot është shumë pak e njohur dhe fragmentare, si dhe mbi kohën e kontekstin se si kanë lindur e janë botuar veprat e tij. Gjithsesi burimet mbeten të pakta. Ajo çka njihet deri më tash nga letërkëmbimi i tij ruhet në fondin e De Radës dhe në disa prej botimeve të veprave të tij.

Botime të deritanishme të letërkëmbimit të Santorit

Një korpus letrash e gjejmë të botuar për herë të parë si shtojcë dokumentesh në botimin kritik të tri novelave të Santorit nga Fortino, Stamile e Tocci². Bëhet fjalë për letra zyrtare të Santorit që janë gjetur pranë arkivit famullitar të San Giacomo di Cerzetto-s si edhe pranë arkivit privat të C. Candreva-s. Ato na ndihmojnë të plotësojmë aspekte të panjohura të jetës së Santorit, vështirësitë ekonomike që e shoqëruan gjatë gjithë jetës së tij, si edhe të dhëna mbi aktivitetin e tij si famullitar i S. G. di Cerzetto-s për mëse 15 vjet. Për t’u përmendur letra që ai i shkruan Madhërisë së tij, Umberto I, Mbret i Italisë, më 8 mars 1892, ku i lutet për një ndihmë prej 5000 lirash për ristrukturimin e kishës ku shërbente si famullitar³. Po të botuara nën kujdesin e Fortinos njohim edhe dy letra dërguar De

¹ “Pjesa më e gjallë e letërsisë, më e sinqerta, ndodhet gjithsesi në letërkëmbimet”. Thënie e Angelo De Gubernatis, citim i marrë prej tij dhe botuar nga De Rada në *Antologia Albanese tradotta fedelmente in italiano da Girolamo De Rada* si epigrafi i shkrimit *Saggio epistolare*. Shih: [De Rada 1896, 27-34]

² Shih për më shumë: [Fortino & 1985, f. 361-380]. Po në këtë shtojcë janë botuar edhe 12 letra, një dekret, dhe një vendim që janë gjetur nga autorët në fondin e Françisk Santorit, në Bibliotekën Qytetëse të Kozencës. Janë rikopjime autografe të vetë Santorit të dokumenteve zyrtare që hedhin dritë mbi emërimin e tij si famullitar i S. Giacomo-s dhe përfshijnë periudhën 1863-1865.

³ Nuk është hera e parë që Santori i drejtohet një autoriteti jo kishtar për ndihmë. Sipas pohimeve të tij në këtë letër, i është drejtuar edhe mbretit Vittorio Emanuele, vite më parë dhe me shumë sukses arriti të sigurojë ndihma për kishën e San Caterina Albanese-s, fshatit

Radës nga Santori⁴. Në 2014 Giovanni Belluscio boton një studim mbi letërkëmbimin e Santorit me De Radën⁵ duke dhënë ndër të tjera edhe të dhëna mbi vendet nga janë dërguar, sasinë e letrave, mënyrën se si Santori i ka firmosur ato dhe fragmente të përmbajtjes së tyre. Pavarësisht faktit se i jemi afruar të dy këtij letërkëmbimi nisur nga vepra të ndryshme letrare të Santorit të marra në analizë prej nesh⁶ studimi i Belluscio-s i paraprin në kohë botimit të këtij studimi. Për këtë po përqendrohemi vetëm në disa aspekte të përmbajtjes së letërkëmbimit, duke paraqitur të dhëna të reja apo duke plotësuar fakte të cituara edhe më parë.

Santori–quel nome soave (ky emër plot hir). Konsiderata të De Radës mbi Santorin

E vetmja provë e drejtpërdrejtë e anës tjetër të letërkëmbimit, pra të letrave që De Rada i ka shkruar Santorit gjendet e botuar në shënimet në fund të librit tek *Rapsoditë kombëtare*⁷. Këtu po paraqesim edhe disa konsiderata indirekte të vjela nga letërkëmbimet e De Radës me personalitete të letrave italiane, bashkëkohës të tij.

Kështu në letrën dërguar Niccolò Tommaseo-s, gjuhëtar, shkrimtar e patriot italian⁸, më 16 shkurt 1864, De Rada i rekomandon nxehtësisht letërmarrësit që ta mbështesë e ta nxisë Santorin në krijimtarinë e tij.

të tij të lindjes. Shkruan Santori: “*Ora il Petente da 15 anni è parroco di un villaggio di circa 1200 anime, chiamato S. Giacomo, frazione del Comune di Cerzetto, Provincia di Cosenza. Vi ha trovato una Chiesa ignuda di Sacri arredi e ruinante di arredi; lesinando sul proprio vitto, vestito ed abitazione, l’ha mediocrementemente provveduta.*” Po aty, f. 377. Shih edhe: [Gradilone 1974, 11].

⁴ Shih për më shumë: [Fortino 1986, f. 70-112].

⁵ Shih më hollësisht: [Belluscio 2014. a, f. 116-128].

⁶ Lidhur me informacionet që përmban ky letërkëmbim sa u takon problemeve të përcaktimit të kontekstit kur kanë lindur e janë botuar veprat mund të konsultohen: për *Valle harës madhe* [Belluscio, 2014.a, 120]; për *Il Canzoniere Albanese* [Bruci 2012, 83-84], [Belluscio 2014.a, 122-123], [Belluscio 2014.b, 109]; për *Il prigioniero politico* [Bruci 2012, 84], [Belluscio 2014.a, 123], [Belluscio 2014.b, 109]; për *Sofia e Kominiatëve* [Bruci 2012, 84], *La figlia maledetta* [Belluscio 2014.c, 13]. Ndërsa për vepra ende të babotuara apo të parashikuara për botime nga Santori mund të konsultohen për *Lexicon* [Bruci 2011, 75], [Bruci 2012, 85], [Belluscio, 2014.a, 122], për një dramë të supozuar si pararendëse të *Emirës* [Belluscio 2014.a, 125], [Belluscio 2014.b, 108], [Bruci 2014, 35-36], për *Kalimeret* [Bruci 2011, 75], [Bruci 2012, 85], [Belluscio 2014.a, 126], për një cikël komedish [Bruci 2011, 75], [Bruci 2012, 84].

⁷ “*Mio Santori,*

Jer sera ricevei i due canti popolari che mi rimetteste: Shkonj një trim kã një rûg e Ajo zonja e rë e Gjikkës, il quale ultimo è per la mia raccolta oggi un prezioso regalo; oggi che una figlia dei Gjicca albanesi, nata ne’ principati rumeni, Dora d’Istria (principessa Coltzof Massalsky) attrae a sè gli sguardi simpatici della colta Europa” Për të lexuar letrën në plotninë e saj shih: [De Rada 1866, 79-80].

⁸ Kësaj letre Tommaseo i përgjigjet duke i dhënë sygjerime stilistike e gjuhësore e duke i porositur që të mos heqin dorë nga lëvrimi i gjuhës shqipe në krijimet e tyre letrare. Shih

Letërkëmbimi i F. A. Santorit me Jeronim de Radën në Arkivin Qendror...

*“Illustrissimo Signore,
(...) Ora mi permetta ch'io abusi della Sua benevolenza, presentandole
un libro e con esso l'autore che mi si raccomanda.
Egli è un monaco francescano mio connazionale. Non ebbe agio, per
iscarsa fortuna, di fare un corso completo di studi, ma a tutto supplì
l'ingegno. Si ritrasse adolescente in un monistero, e, dopo poca
istruzione, facevami tenere in Napoli nel 1840 un manoscritto di poesie
albanesi, delle quali le scelte e da me tradotte si pubblicarono da poi con
successo. Non se ne trova oggi più copia. Nel 1848 pubblicò un poemetto
in versi italiani framezzato da canzoni albanesi, il quale gli attrasse
malevolenza e inquietudini dal Governo Borbonico. Dopo il 1860 perché
non poté approvare lo spogliamento de' monaci e la distruzione
dell'opera di santi, fu malversato dall'autorità. Aveva ristaurato un
monistero e apertolo per fondervi ogni suo avere, ed ebbe a sloggiarne.
Ora è in lo stampare un grande dramma albanese; e prima ha dato in
luce il romanzo che ho l'onore di mandarle. In provincia languente ed a
cui non è in stima alcuna la scienza, egli è scorato, ed una parola di Lei
cui l'Europa onora, gli sarà quasi una pioggia feconda. Il La prego
quindi vivamente di prendere in considerazione quest'operetta, che
d'altro lato è il quando più fedele e vivente che sia mai fatto della vita
calabra, e di segnarmene l'impressione avuta.
Con rispettosa stima mi ripeto,
Suo Devotissimo e Affettuosissimo Servitore
Giro. de Rada”*

Më 1893, në një letër drejtuar një tjetër personaliteti të rëndësishëm, kontit Angelo de Gubernatis, glotolog, pikë e rëndësishme referimi edhe për vetë De Radën deri në atë masë sa e quan “il mio angelo protettore”, lexojmë se Santori ftohet nga De Rada të bashkëpunojë në projektin *Folclore d'Italia*. Bëhet fjalë për një projekt-iniciativë të ndërmarrë nga Anxhelo de Gubernatis për të mbledhur folklorin italian e ndërmjet të tjerash edhe atë të arbëreshve të Italisë. Vetë De Rada sheh një mundësi të rigjallërimit të ëndrrës së tij të kahershme dhe e informon kontin se ka ftuar, ndërmjet shumë miqve të tjerë edhe “il grande nostro poeta albanese Fra Antonio Santori, ora afflitto parroco d'un povero villaggio”⁹. Dy vite më vonë, pra një vit pas vdekjes së Santorit, De Rada do t'i shkruante kështu A. De Gubernatis:

*“Ho creduto sottometterLe il mio Prologo allo “Scanderbegh” che solo
col “Milosao” a un principio, medio e fine, e solo de' miei conati che*

për më shumë: [La Luna 2006 f. 89-90] .Argumenti është rimarrë edhe nga [Belluscio 2014.c, 12].

⁹ Shih për më shumë: [Fortino 2003, 179-255]. Citimi është shkëputur nga letra e De Radës dërguar A. de Gubernatis nga Maqi (Macchia Albanese) më 5 shtator 1893. Po aty, f. 219.

*forse Ella non ebbe; e poi fra tutti è un dramma del Padre Fra Antonio Santori, nome soave, morto al 7 settembre dell'anno scorso, poeta grande.*¹⁰”

Bashkëpunime letrare

Një ndër argumentet që mbizotëron në letërkëmbim ka të bëjë me veprat letrare që Santori kishte ndër mend të hartonte, po hartonte apo që po shihnin dritën e botimit. Interesant është fakti që në fillim do të njohim një Santor të ndrojtur e të pasigurt që i besohet tërësisht De Radës deri në përzgjedhjet e poezive, redaktimin e veprave apo përkthimin e tyre. Që në letrën e parë, ende djalosë i frymëzuar, por dyshues për vlerat e tij, Santori i kërkon De Radës që të shprehë një mendim për vargjet apo rimat që ka shkruar me aq kujdes (*le ò scritte con tal premura*) dhe mirëpret vërejtjet e tij të mprehta (*le sue acute osservazioni*) dhe gjykimin e tij të hollë (*sagace giudizio*), duke i dhënë me shumë gjasa edhe lejen për t'i koregjuar si t'i duket më mirë¹¹. Për t'u vënë në dukje edhe pohimi i singertë i Santorit, që do të bëhet edhe leitmotivi i gjithë veprës së tij, se ai shkruan për të përhapur gjuhën e tij të lindjes, shqipen, dhe jo për të rendur pas lavdisë.

“Il pezzo “Fiutturun s’ëndërrima” con le due odi di cui mi fa menzione non me li trovo, perciò segua quel le detta il suo alto pensiero, basta ciò per intendermi nel resto. Crederei di potersi perdonare la caduta della prima ottava sendoché in essa io fo le scuse di non aver voluto scrivere; onde mi raccomando a coloro mi compartiranno l’onore di leggere i miei versi di non biasimare me unassieme con loro perché il mio fine è stato innocente; ò inculcato poi ciò con maggior fervor a nazionali ai quali più di presso può esser noto il mio sentimento che è stato di promuovere la natia favella, e non mica il desio della gloria. Del resto se tanto non le fa molto grado, ecco un soneto che meglio può stare in sua vece, che porterà il titolo di Canghieglii.

[Kangjelë]

Ndo bumbllizon te dheu shërbia ime
Pantehinjë u se piallë shum thamasī,
Pëse ndo ndianë me veshë, ndo ruanë me sī
Së gjegjën o sheh mose dheza shërtime

Oh! Të noeronjë se kīo zëmër’ e brime
Së prët prë zae formadhe ndonjë haīdhī
Shkruaīti se të nderoj gjuhën arbrī
E s’do më se këtë; nderë o llautime

U pres e zëmra tas ndë gjī gjëmon

¹⁰ Po aty, f. 227.

¹¹ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, 1 maj 1843, AQSH, F. 24, D. 54/9, fl. 12.

Letërkëmbimi i F. A. Santorit me Jeronim de Radën në Arkivin Qendror...

*E trëmburë! Çë? Ndo jan llautuora o shara
Së kam spiaxhirë; ndo prapa meje ron*

*Skontrepsurë imi ëmërë [...] ¹²prë nderë të
Të ventit ku gjellonjë; lote të rara
S'u panë nka sitë e mia pr' a [...]rë një herë!" ¹³*

Në një letër të datës 20 gusht 1869, gjejmë një tjetër krijim të Santorit, një ninullë që ai ia kushton një foshnjeje të sapolindur në fshat së cilës i kishte vënë edhe emrin Fanëmire. Vetë Santori pohon se si shumë nga këngët e krijuara prej tij edhe kjo ninullë që këtu po e botojmë për herë të parë, shpejt u bë e njohur dhe këndohej nga të gjithë.

*"Eccoti una delle ninne della Bimba, già divenuta popolare e di
tutte le case
Fānmirele, vikërele.
Kūr m'e thua një t'ëmbël fjal?
Kūr më thua: ti mëmarele
Nënk e dī se u ndë tal
Sisën dua, posi do ti
Të qëllonemi nani
Fānmiruqe, vikërruqe
Ç'ashtu ngure, shtridhe e shtrique
Aq sa faqen bën të kuqe
E sërret si kardhulliqe
Cila çë më kã, më do
[...] së thot një hër se jo
Fanmirele, vikarele
Tron[to]file prë ndë lule
Kuqe e bardh si shtupagjele
Mes je mbiedhur si kukule.
Pallarë mbi monosaqe
Dallanishe prë ndë maqe
Leje via, se m'e dëthite
Çë do më nka kjo sis?
Tas kapiqin m'e lëpите*

¹² Në transkriptimet e bëra prej nesh kllapat katrore rrethojnë rindërtimin tonë aty ku ka qenë e mundur ose tri pikat aty ku ka qenë e pamundur për shkak të dëmtimit të pariparueshëm të letrave.

¹³ Po aty, fl. 12. Këtë sonet të parë të Santorit e kemi botuar për herë të parë në një shkrimin tonë kushtuar jetës dhe veprës së Imzot Emanuele Giordano-s, në numrin përkujtimor të revistës *Jeta Arbëreshe*. Shih: [Bruci 2015, 37]. Transkriptimi i këtij soneti dhe i fragmenteve të tjera në arbërisht që pasojnë është yni. Për alfabetet e përdorura nga Santori dhe përfaqset me alfabetin e shqipes së sotme standarde shih: [Bruci 2012, f. 73-90].

*E kulluqeza m'u gris!
Ndo pëstana jetrën do
Ftëj përpara, e pra kërko*".¹⁴

Në më shumë se një letër Santori i përsërit De Radës pamundësinë e tij për të botuar apo siç shprehet ai "për t'u dhënë jetë atyre bijve letrarë, pak a shumë të përfunduar si trup, por pa shpirtin e botimit" megjithë dëshirën e madhe për të kontribuar për të mirën e mëmëdheut. Në pamundësi për të përballuar sakrificat e shumta morale e materiale do të "dënojë me harresë" veprat e tij. Letra e 30 gushtit 1869 na e konfirmon më së miri këtë.

*"Ti è detto più volte, che io, anche dormendo qui, posso realizzare mensilmente cinquanta lire, e queste mi valgono più che le centoventi di costi; e senza sottopormi a compressione di naturali bisogni, e ad assumere nuove abitudini e risecamenti di libertà. Nondimeno a tutto questo mi assoggetto, pel riguardo dello scopo della Patria utilità, e per la voglia di potere dar soffio di vita a quei figli letterari, che ànno corpo più o meno compiuto, e mancano dell'anima della pubblicità. Ma quando poi dovessero costarmi troppi sacrifici e morali, e materiali, condannerò ogni cosa all'oblio e farò di godere alla meglio un certo presente, più che angustiarli alla ricerca di un migliore ed incerto avvenire."*¹⁵

Ka qenë një traditë e kohës që pjesë të veprave të hartuara në dorëshkrim shpesh i jepeshin për t'u lexuar edhe personaliteteve të artit apo të kulturës për të marrë një vlerësim paraprak apo njerëzve që kishin tituj a mundësi financiare për të ndihmuar për botim. Përveç aspekteve pozitive kjo mund të ketë ndikuar negativisht: moskthimi i dorëshkrimeve ka bërë që një pjesë e tyre të humbisnin në rrjedhë të kohës duke lënë në trishtim të plotë hartuesin e tyre. Në letërën që pason do ta hasim këtë fakt. Santori na sqaron gjithashtu se përveç shkrimit të komedive ai angazhohet edhe në vënie e tyre në skenë, duke u shndërruar kështu në regjisor e duke gjallëruar jetën e të rinjve të fshat.

*"Caro Girolamo,
Essendo in S. Giacomo, a casa di Giovanni, pervenne una tua, nella quale un po' stranamente, chiedevi notizie di me, come se io fossi nell'altro mondo, e non sapevi ove diriggermi tue lettere! Io non ti è scritto, perché nell'ultima tua mi dicevi che, come prima avresti avuto le due 1^e dispense a fogli della Grammatica, me li avresti spediti. Fu vano l'attendere; finì però a sorpresa, come li vidi giu [presso] Stamile. Questo procedere mi à fatto ragionevolmente fantasticare chi sa quante cose. Stetti in bilance se avessi o no dovuto scriverti, menandone querela, o vendicarmi con successivo silenzio; ma perché l'animo mio verso te à*

¹⁴ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, 20 gusht 1869, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 23.

¹⁵ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 30 gusht 1869, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 24.

tale pendenza che non posso per guisa deviarla, soffocata perciò qualunque discreta od indiscreta supposizione, ti ho scritta la presente; per occasione che la imposta in Castrovillari. Ciò premesso posso dirti che certo non mi avrai ritirato dal Signor Baroncino il Manoscritto delle Commedie, ed è facile che lo vi perda, e mi dorrebbe quanto mai. Nel prossimo trascorso carnevale ho fatto rappresentare da dieci giovinotti del volgo, una piccola commedia albanese, la quale à prodotto un'effetto incredibile. Più improvvisai alcuni strambotti per canto, i quali poi àn dato spinta ad un libro originali[ssimo], oramai compiuto, cioè una dipintura lepida e vivace delle ma[...], [...]sercenti mestieri, e dei principali umani vizî. Esso costa di circa 50 [...] improntate di tale facilità o chiarezza, che basta leggerle, per saperle a[...]. Ne ò fatta la traduzione, serbandolo al più possibile la lettera o la postur[...] rebbe un bel volumetto tascabile in 32^{mo} ma che però non avrà sorte migl[iore de]gli altri suoi fratelli, che dormono sotto la polvere. Non avendomi più interlo[...] to della Steinperia; significa che nulla ài realizzato e tradotto in atto, e che le n[o]stre cose vanno come al solito, chine al peggio. Io tiro avanti come Dio vuole. [Pia]cerebbemi tuttavia che andassi a meglio tu, e pel tuo speciale, e pel comun ben[e]. Non so che dirti o chiederti più. Se ài di meglio, e credi farmene parte, mi sarà [di] consuolo. Serbati sano: abbracciami i tuoi figli; salutami alcuno degli studenti o amici che ancora ricorda di me, e credimi al solito Aff(ettuosissi)mo Francescantonio Santori”¹⁶

Gjithsesi dëshira e Santorit për të shkruar e për të eksperimentuar në gjini të ndryshme¹⁷ mbetet më e fortë se frika, tanimë e kthyer në bindje, se veprat e tij do t'i mbulojë pluhuri i harresës:

“(...) In tal caso potresti procurarmi un'applicazione decente e di qualche lucro insieme, avermi al tuo fianco e studiare e per l'opportunità della benedetta stamperia od altro che ci venisse buono per la

¹⁶ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 24 maj 1871, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 31. Ia rikujton përsëri De Radës: “Ora ti scrivo e per augurarti felici le natalizie feste, e per sapere notizie di tua salute fisica e morale, per rinovarti la ricerca delle mie Cinque Commedie date a leggere al Baroncino”. Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 20 dhjetor 1871, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 34.

¹⁷ “Io questo anno mi sono occupato a scrivere un Saggio di Grammatica Italiano in versi, estratto dal Corso Filologico Razionale di Lorenzo Zaccaro. Vi ho considerata la parola morfologicamente, etimologicamente e sintassicamente. Da principio mi parve cosetta meschina: ha preso indi dimensioni rimarchevoli, ed ora mi lusinga quanto basta per isperarci. Quindi se codesta stamperia progredisce, potremmo in essa farne una edizioncella economica, a motivo di sperimentare come sarà ricevuta dal pubblico.” Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 30 shtator 1872, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 36.

*pubblicazione delle opere che dormono. Io, come ti ò detto, ò scritto un'altra operuccia poetica per incidenza; ma ora non sento neppure la voglia di ripulirla, pensando che sono carte sacre al vento della polvere".*¹⁸

apo

*"(...)Io benché tornassi nel medesimo luogo alquanto degradato, pure col desiderio di pubblicare alcuna delle tante mie cosette, che dormono, sarei disposto a sobbarcarmi a tale umiliazione".*¹⁹

Kemi zgjedhur të botojmë më poshtë të plotë një letër të Santorit ku jepet në mënyrë të zgjeruar vlerësimi për një ese të shkruar prej tij (Saggio Epico per la futura Palingenesia dell' Umanità) dhe dërguar për vlerësim Edoardo Martinetti-t në Romë. Ky i fundit nuk ia këshillon ta botojë si për përmbajtjen ("il tema vasto, vastissimo, profondamente filosofico") ashtu edhe për formën ("scrivere versi che fossero comprensibili a tutti"). Për Martinetti-n kjo punë e autorit tonë mund të merrte duartrokitjet e njerëzve të ditur, fatkeqësisht aq të rrallë sa lundëtarët e vetmuar në detin e pafund ("rari nantes in gurgite vasto"), por do të ishte e papërputhshme me shijet e shumicës së lexuesve, shije që kishin ndryshuar shumë për shkak të përhapjes së shkollës së re. Kaq mjafton për të provokuar zemërimin e Santorit dhe dëshirën për t'iu kundërvënë hapur kësaj përpjekjeje për ta këshilluar t'i shmangej verizmit e të heshtëte ("perché consigliarmi indefinitamente a tacere"):

*"Caro Girolamo"*²⁰

Ti mando accluse dieci lire per affiatore quanto si può da mia parte La Bandiera Albanese. Ora però che ài cominciato a pubblicare il mio dramma, facendosene la composizione sarebbe opportunissimo farne tirare a parte un dato numero di copie, onde avere per intiero il libro, che certo farà altra impressione letto a fiato continuo, e veduto in corpo. Tempera le lodi della famiglia Capparelli che non le merita; specialmente gl'ingratissimi e sgarbati attuali. Tosto che hai dato quel granello d'incenso al Vescovo Parladore puoi spedirgli una copia e chiederlo di Associazione-Direz(ion)e Napoli per Orsogna.

Ecco che mi scrivono da Roma sul Saggio Epico per la futura Palingenesia dell'Umanità.

Premesso un esordio cerimoniale addviene a queste parole:

"Comunque sia eccole dunque le impressioni suscitate nella mia mente dopo aver letto il pregevole suo lavoro. Il Tema vasto, vastissimo,

¹⁸ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 22 shtator 1871, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 33.

¹⁹ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Caterina Albanese, 30 shtator 1872, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 36.

²⁰ Shih: Letër e Santorit drejtuar De Radës, S. Giacomo di Cerzeto, 11 shkurt 1887, AQSH, F.24, D.54/9, fl. 38-39

profondamente filosofico, è ben tratteggiato e quantunque la forma in alcuni punti lascia alcun che a desiderare. Va bene ch'Ella ha voluto scrivere versi che fossero comprensibili a tutti, nulladimeno ciò non deve andare a scapito della dignità del verso medesimo, dalla S. V. a mio parere, in certi luoghi adoperato un po' troppo pedestremente.

Ciò per altro è un neo, una inezia cui potrebbe facilment(e) avviare con un non difficile lavoro di lima; ed io son certo che la S. V. in pochissimo tempo saprebbe togliere tale inconveniente, persuaso della verità delle mie osservazioni.

In quanto poi alla convenienza o meno di pubblicare per le stampe il suo lavoro, io la consiglio apertament(e) di non farlo. Viviamo disgraziatam(ent)e in epoca in cui i buoni studî sono propriamente all'apice della depressione, la letteratura afflitta dagli ibridi parti del verismo, la pornografia trionfante in tutta la linea... se Ella dunque pubblicasse il suo lavoro, certo non le mancherebbe il plauso dei veri dotti rari nantes in gurgite vasto, ma la generalità degli uomini poco si occuperebbe del suo lavoro, traviata com'è nel gusto, per opera e virtù della scuola novella.

Queste sono le mie osservazioni, le quali se non altro pregio, avranno almeno quello di essere dettate dalla coscienza. –Roma, 7 febbrajo 87. Edoardo Martinetti.”

Questa risposta per le generali mi pare riscontro alla mia lettera piuttosto che giudizio provvocato dalla lettura del manoscritto, toccato troppo leggermente. E poi o à o non à valore poetico, scientifico e di arte. Che ne abbia ei lo assevera ripetutamente, e perché dunque non apporlo alla corrente rovinosa del verismo? Perché consigliarmi indefinitamente a tacere? Se non à merito alcuno perché non segnarmi partitamente le parti deboli per cui avrebbe non iscampato un certo naufragio? Io infelicem(ent)e non mi trovo in posizione di poterlo pubblicare, altrimenti dietro questa parziale condanna al silenzio lo avrei slanciato nell'oceano turbolento del presente letterario mondo, precisam(ent)e, con l'aspettazione che afferrato l'argomento da ingegno più robusto e maneggiatore più felice di versi, esplicasse con miglior forma la vastissima tela, e crease un argine potente al verismo pornografico e falso, con un verismo religioso e universale, magnanimo, umanitario, ecc. Mi dirai: dunque tutta questa roba hai trattato tu in meno di un'anno? Che non fosse piuttosto albagia o cecità? Il poco detto sopra da chi non mi conosce personalmente risponde all'obbiezione. Pel resto parmi di averti detto che il complesso dello schema, o vero, o verosimile assolutamente, mi pare ottimo; benché la veste non corrisponda al gigantesco personaggio. Me lo sapea purtroppo e non volli ovviarvi, perché saggio e non opera compiuta. Essa poi ha fisionomia nuova; del tutto nuova. Il protagonista è l'umanità non solo della Terra, ma di quella di ogni altro mondo, e le sue aspirazioni. Quante altre cose potrei

dirti?... Ma basta. Ritornandomi il manoscritto, se me la sentirò a ricopiarlo, potrò mandartelo a leggere. Se non, se lo divori pure la polvere con essemeco!

Statti sano, continua i tuoi lavori e fa di credere fermamente e convenevolmente a Dio, e raccomandargli in ogni momento con questa orazione.

“Padre nostro sempiterno che sei presente in tutto, sia santificato il nome tuo: Domini sempre la potenza, la sapienza e la misericordia tua. Sia fatta la tua volontà; ogni gloria sia tua, come nell’universo così sulla Terra. Dacci oggi il nostro pane quotidiano, e conferma le nostre volontà a rimettere a’ nostri debitori, come noi desideriamo che ci sia rimesso dalla vostra divina maestà. Scampaci dalle tentazioni; liberaci da ogni male. Così sia.

*Ti abb(racci)o e sono
Francescantonio Parroco Santori”.*

Bashkëpunime publicistike

Santori megjithë angazhimet për të qenë bashkëpunëtor i gazetave që De Rada ka botuar, nuk ka lënë gjurmë të shkrimeve publicistike. Por është i pranishëm me botime letrare. Është rasti të përmendim këtu botimin e poemës (piccola cantica) Vallë harës madhe (Vale garees made) në numrin inagurues të gazetës L’albanese d’Italia, më 23 shkurt 1848. Kjo gazetë dilte në Napoli dy herë në javë. Letra që pason, me shumë gjasë pranverë 1848, pa vend dërgimi e datë, na njeh me admirimin që provon Santori dhe falenderimet e tij për De Radën si botues.

“Carissimo Girolamo,

Ho ricevuto i due primi numeri del nostro foglio L’Albanese d’Italia e ti confesso ingenua la mia forse debolezza, il solo titolo appena frugato a’ avuto forza [ad] estrarre le lagrime, donde questa magia? Mi è difficile numerare la varietà delle cause che avessero potuto animarla! Basta, però ti dico per tutt’altro, che un sospetto che rendesi ogni giorno basata credenza, rende paurosa tutta questa contrada; del resto tornando sul tuo foglio, in tempo che ti manifesto l’ammirazione mia sulle due prime tue parlate, debbo ancora esternarti la più sincera gratitudine per la pubblicaz(ion)e, traduz(ion)e e correzione d[e]lla piccola cantica inviatati. Noto sempre la benedetta ortografia né semplicizzata, né adattata ancora. Se ti compiacessi collo stesso metodo, farmi leggere, e la parafrasi, e le altre due canzoni, che ài tenute per mano di Consorti Antonio, auresceresti il mio contento. Ricordati infine diriggere, o lettere, o fogli=Castrovillari per Corigliano, e mi verranno subito. Fogli ne manderai uno diretto a P(ad)re Bernardino di Falconara, l’altro al Sig(nor)e D. Domenico Ferraro Correttore dei PP. Minimi, l’altro a me. Colla continuazi(o)ne invierai à due primi i due numeri usciti. Per carlini ventisette di tremestre associazione conoscerai me, e potrai disporne

Letërkëmbimi i F. A. Santorit me Jeronim de Radën në Arkivin Qendror...

*come meglio credi. Impiegami dove mi credi abile per te, e per la patria,
e credimi sempre*

Tuo obbi(dissimo) affe(ttuosissi)mo amico.

P(adre) Antonio Santoro di S. Caterina”²¹

